

Evelyn Nuñez, Ed.D.
Shefe e Shkollave

17 Mars, 2022

Të dashur prindër dhe familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Në përputhje me Qëllimet dhe Objektivat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ne po përpiqemi vazhdimisht të krijojmë kushte arsimore që të gjithë nxënësit të kenë sukses. Në vjeshtën e vitit 2021, si pjesë e një strategjie më të madhe për krijimin e atyre kushteve, Drejtoria filloi qasjen e saj me faza për standardizimin e orareve të fillimit dhe përfundimit të ditës në shkollat tona. Standardizimi i orëve është krijuar për të zvogëluar sasinë e kohës që studentët shpenzojnë në autobuza, për të ndihmuar në sigurimin e autobuzave në kohë më shpesh dhe për të lejuar pastrimin e vazhdueshëm të zonave me prekje të lartë në autobus midis turneve. Kjo përpjekje përmirëson përvojën e përgjithshme të transportit për studentët tanë, edhe pse ne vazhdojmë të përballemi me një mungesë shoferash autobuzi në mbarë vendin.

Siç u diskutua në forumet e mëparshme gjatë viteve shkollore 2020-2021 dhe 2021-2022, ne kemi filluar të zbatojmë një orar autobuzash me 3 nivele. Në fillim të vitit shkollor 2021-2022, filluam t'i përafrojmë shkollat në tre nivele dhe bëmë ndryshime thelbësore në shkolla, nga Kopshti deri në Klasat e 8-ta. Këtë vjeshtë po bëjmë rregullime shtesë të orarit për vitin shkollor 2022-2023. **Duke filluar nga kjo vjeshtë, të gjitha shkollat e mesme (High School) të rrethit, me përjashtim të katër shkollave, oraret e të cilave duhet të përputhen me institucionet partnere, do jenë në orën 9:00 të mëngjesit – duke përfshirë shkollat e mesme High school) që përfshijnë klasat e mesme. Programet Pre – K që ndodhen në shkollat e mesme do të ruajnë orarin aktual.** Të gjitha shkollat e tjera fillore – shkollat që shërbejnë Pre -K deri në klasën e 8-të – do të mbajnë oraret e tyre aktuale. Ky vendim u informua nga reagimet e komunitetit të mbledhura në pranverën e vitit 2021 dhe studimi nga [Akademia Amerikane e Pediatriisë](#) që tregon se koha e mëvonshme e fillimit për nxënësit e shkollave të mesme (high school) u mundëson atyre të mbërrijnë në shkollë më vigjilente dhe më të gatshëm për të mësuar. Përveç kësaj, duke qenë se shumica e nxënësve tanë të shkollave të mesme (high school) janë të përgjegjshëm për të shkuar vetë në shkollë, oraret e mëvonshme të fillimit promovojnë udhëtime më të sigurt në mëngjes dhe pasdite.

Jeni të ftuar të merrni pjesë në një nga katër Forumet e ardhshme virtuale të Komunitetit, ku ne do të hymë më thellë në këto rregullime dhe do t'ju japim një mundësi

Evelyn Nuñez, Ed.D.
Shefe e Shkollave

për t'i ofruar Drejtorisë komente mbi mbështetjen që mund t'u nevojiten familjeve ndërsa planifikoni përpara për vitin shkollor 2022-2023 si rezultat i rregullimeve të orarit të fillimit dhe mbarimit të shkollës.

E Martë, 22 Mars 2022 (*Seancat do të interpretohen në mandarin, portugeze dhe spanjisht*)

- 13:00pm -14:00pm : Ju lutemi regjistrohuni për seancën e orës 13:00pm [këtu](#)
- 19:00pm deri në 20:00pm : Ju lutemi, regjistrohuni për seancën e orës 19:00 [këtu](#)

E Hënë, 28 Mars 2022 (*Seancat do të interpretohen në Mandarin, Portugeze dhe Spanjisht*)

- 11:00am -12:00pm : Ju lutemi regjistrohuni për seancën e orës 11:00am [këtu](#)
- 18:00pm deri në 19:00pm : Ju lutemi, regjistrohuni për seancën e orës 18:00 [këtu](#)

Familjet do të kenë gjithashtu mundësinë të plotësojnë një anketë të shkurtër në internet në lidhje me orarin për vitin 2022-2023 që do të jetë i disponueshëm në nëntë gjuhë. Anketa do të përfshijë pyetje në lidhje me mbështetjen që mund t'u nevojiten familjeve ndërsa planifikojmë për vitin shkollor 2022-2023. Anketimi në internet do të shfaqet drejtpërdrejt pas forumeve të komunitetit më 28 Mars dhe një lidhje/link do të ndahet në atë kohë.

Ne e kuptojmë se ndryshimi i kohës së fillimit dhe përfundimit mund të paraqesë vështirësi për familjet dhe mbetemi të përkushtuar për t'u ofruar mbështetje familjeve kudo që të jetë e mundur. Ne gjithashtu do të vazhdojmë të komunikojmë përditësimet herët dhe shpesh, në mënyrë që të mund të bëni çdo rregullim të nevojshëm familjar përpara kohe për të siguruar që fëmija juaj të mund të ndjekë shkollën në kohë çdo ditë në përputhje me këtë orar të ri. Ju inkurajoj të vizitoni rregullisht [faqen e internetit të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias](#) për informacion më të përditësuar.

Faleminderit.

Sinqerisht,

Evelyn

Evelyn Nuñez, Ed.D.
Shefe e Shkollave

Evelyn Nunez, Ed.D.
Shefe e Shkollave

SHEFE E ZYRËS SË SHKOLLAVE
Suite 2164
440 North Broad Street
Philadelphia, PA 19130